

DITARI EKONOMIA OPINIONE SPORTI **KULTURA** ZIP AUTO & TECH KIDZ

WEB TV

## KULTURA

BALLINA / KULTURA / KULTURA

# Arkitektura e jetës nën diktaturë

Publikuar: 07.09.2014 - 09:16

Komente (0)

Publiko në:



Ardian Christian Kyçyku është shkrimtari që rindërton arkitekturën shpirtërore të jetës nën diktaturë. Vepra e tij është si një pikturë me jetën e vvarë të shqiptarit. Ato lëvizin,

ndërrojnë toka e kohë, por shqiptari i vrarë është gjithnjë aty dhe nën pushtetin e të tjerëve.

Në Berlin të enjten e shkuar është paraqitur romani i ri i autorit “Home”. Mbrëmja e leximit e mbajtur në hapësirat e Literatur Haus mbledhi në këtë ditë shtatori një numër të madh adhuruesish të letrave shqipe. Mbrëmja letrare u organizua nga Shtëpia Botuese PA me seli në Prishtinë dhe Berlin, ndërsa pjesërisht u mbështet nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Gjermani.

**Zëri: Zoti Kyçyku, ju gjetëm sonte këtu në hapësirat e Literatur Haus në Berlin me rastin e paraqitjes së romanit tuaj “Home”. Si e ndjeni veten këtu në mesin e shqiptarëve që jetojnë në Berlin? Cila është përshtypja e parë?**

**Kyçyku:** U ndjeva në shqip, ose njëlloj sikur të qemë mbledhur në një libër të këndshëm. Nuk qe e rastit që pikërisht romani “Home” e krijoi këtë mundësi. Në krye të librit kam shkruar se të gjitha ngjarjet që pasojnë mbështeten në një libër të vërtetë. Gjithmonë më është dukur se, kur shumë ngjarje dynden të hyjnë në libra, disa të tjera dalin nga një libër i pashkruar i Mërgimit shqiptar dhe fitojnë njëfarë jete të mëvetësishme. Mikpritja e shqiptarëve të Berlinit, përkushtimi i botueses, zonjës Feride Berisha, bisedat, shija e takimit letrar, janë mbresëlënëse, sidomos në kohëra kaq të vështira për letërsinë e mirëfilltë. Nga ana tjetër, qyteti është nga ata të paktët ku shumë shpejt bindesh se jeton prej vitesh.

**Zëri: Çfarë është libri “Home”?**

**Kyçyku:** Romani i një brezi që nuk ka ku të kthehet, por që ka kur të kthehet. Zhvendosja e një sasive historie dhe gjeografie në një cilësi kujtese e metafore. Me çmim gjaku, por edhe boje.

**Zëri: Simbolet si shtëpia, dheu, çelësi, kulla, anketa; ju sikur luani me njëjës dhe shumës?**

**Kyçyku:** Në këtë roman ngjarjet, qeniet dhe sendet janë shumë afër simboleve që përfaqësojnë dhe që i përfaqësojnë. Në betejën e heshtur të shumësit që gjithmonë, edhe historikisht, me ose pa vetëdije ngulmon të zhdukë njëjës, afrimi i mësipërm shndërrohet në një akt vetëmbrojtjeje i shpirtit.

**Zëri: Z. Kyçyku, ju shkruani edhe në shqip, edhe në rumanisht. Në cilën kulturë gjuhësore ndiheni më mirë? Apo janë gjërat e ndryshme që shkruhen në gjuhë të ndryshme?**

**Kyçyku:** Gjithmonë është libri ai që zgjedh gjuhën. Në prozë gjërat nuk ndodhin si në poezi, sado poetike të jetë proza. Për fat, shqipja dhe rumanishtja mbështeten dhe zbërthejnë realitete kulturore dhe jetësore të ngjashme, dhimbje apo pyetje madhore që shqetësojnë gati njëlloj, dhe të dyja gjuhët, pavarësisht nga librat, përfshijnë njëfarë rruzulli ballkanik e evropian. Mund të këqyret edhe si një sy i fshehur që sheh shumë

më tepër nga sa thotë, për hir të një heshtjeje stërgjyshore që dëbon llafet.

**Zëri: Letërsia sot dhe letërsia ndërmjet kufijve të Kosovës e të Shqipërisë, se ka vështirësi në depërtimin e letërsisë shqipe nga Kosova në Shqipëri, ndërsa anasjelltas jo?**

**Kyçyku:** Këto vështirësi janë kalimtare, sado që janë të dhimbshme edhe për zemrën, edhe për xhepin. Një zgjidhje e shpejtë e tyre do të sillte kohë të çmuar edhe për lexuesit, edhe për botuesit, edhe për shkrimtarët. Apo të gjithë kanë nga pak faj dhe duhet të mos e kërkojnë më zgjidhjen në zona të tjera të shoqërisë?! E qartë është vetëm që pushteti i thellë i letërsisë nuk varet as nga qarkullimi i librave, as nga pengesat jashtëletrare, sepse është dhunti, jo zanat.

**Zëri: Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Ardian Kyçyku. A është kjo një vazhdimësi e një misioni kulturor, apo letrar, meqë prej më shumë se njëzet vjetësh edhe ju punoni që të forcohet ura kulturore mes Rumanisë dhe Shqipërisë?**

**Kyçyku:** Në letërsi asgjë nuk është e rastit, por për vazhdimësi më mirë flasin librat, sesa një autor, ose tjetri. Lasgushi dhe Mitrushi, me të cilët kam lidhje farefisnore, janë vërtet gjallë në Bukureshtin tim, qytet ku gjej edhe sot e kësaj dite copëza nga Pogradeci i hershëm dhe nga bota shqiptare e viteve 20.

**Zëri: Tani një pyetje nga ato që shpesh nuk u shkojnë fort autorëve, duke iu referuar përmbajtjes së romanit: një i ri mërgon nga Shqipëria në moshë të re. Sa ka në librin “Home” elemente autobiografike?**

**Kyçyku:** Besoj se është vetëm dhimbja e tmerrshme e shkëputjes nga vendlindja dhe e detyrimit që, për nuk dihet sa kohë, do ta flasësh gjuhën amtare vetëm me vete. E meqë ende nuk më qe botuar asnjë libër, unë jo vetëm flisja, por edhe shkruaja me vete, çka e bëri dhimbjen aq të thellë, sa ndoshta m’u dha e drejta të shkruaj edhe për vuajtjet e atyre që nuk shkruajnë, siç është shqiptari i shumëfishtë Home Çkena.

**Zëri: Z. Kyçyku po të doja të të shtroja një pyetje të vështirë, cila do të kishte qenë ajo?**

**Kyçyku:** Tani pikërisht përgjigja e kësaj pyetjeje më duket pyetja më e vështirë.

**Zëri: Ju falënderoj shumë për bisedën dhe ju dëshiroj frymëzime, shtegtime në botën e madhe të fjalëve.**